

V E N D I M

Nr. 246, datë 29.3.2017

PËR

NJË NDRYSHIM NË VENDIMIN NR.718, DATË 29.10.2004,
TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE, "PËR LISTËN E PERSONAVE
TË SHPALLUR SI FINANCUES TË TERRORIZMIT",
TË NDRYSHUAR

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 5, pika 1, 14, pika 1, 18, pika 1, 25, pika 1, dhe 28, pika 1, të ligjit nr.157/2013, "Për masat kundër financimit të terrorizmit", me propozimin e ministrit të Punëve të Jashtme, Këshilli i Ministrave

V E N D O S I:

Në listën e personave të shpallur si financues të terrorizmit, sipas rezolutave të Këshillit të Sigurimit ("Lista e OKB-së"), që i bashkëlidhet vendimit nr.718, datë 29.10.2004, të Këshillit të Ministrave, "Për listën e personave të shpallur si financues të terrorizmit", të ndryshuar, bëhet ndryshimi, si më poshtë vijon:

Në listën e shkronjës "C" të titulluar "Lista e individëve anëtarë ose bashkëpunëtorë me organizatën ISIL (Da'esh) dhe AL-Qaida", çregjistrohet individi i renditur në shkronjën "a" sipas ndryshimit, bashkëlidhur këtij vendimi, në listën e konsoliduar të Këshillit të Sigurimit të OKB-së, për

personat që janë anëtarë, bashkëpunëtorë apo financues të organizatës ISIL (Da'esh) dhe Al-Qaida.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në "Fletoren zyrtare".

KRYEMINISTRI

EDI RAMA

Në mungesë dhe me porosi

ZËVENDËSKRYEMINISTRI

NIKO PELESHI


**MINISTRI I PUNËVE
TË JASHTME**

DITMIR BUSHATI

Në mungesë dhe me porosi

ZËVENDËSMINISTRI

ODETA BARBULLUSHI



**AZHURNIMI NË LISTËN E PERSONAVE TË SHPALLUR SI
FINANCUES TË TERRORIZMIT**

SIPAS REZOLUTAVE TË KËSHILLIT TË SIGURIMIT
("LISTA E OKB-së")

**C. LISTA E INDIVIDËVE ANËTARË OSE BASHKËPUNËTORË ME
ORGANIZATËN ISIL (Da'esh) dhe AL-QAIDA**

a) Lista e ndryshuar në "Lista e individëve anëtarë ose bashkëpunëtorë me
organizatën ISIL (Da'esh) dhe Al-Qaida";

1. FAHD; MUHAMMAD; 'ABD AL-'AZIZ; AL-KHASHIBAN


Shënim: Gjeneralitetet e tjera për personin, emri i të cilit është renditur më sipër,
mbahen në Drejtorinë e Përgjithshme të Parandalimit të Pastrimit të Parave.

NR.PROT.1785/15
DATË 30.3.2017

MINISTRISË SË PUNËVE TË JASHTME
MINISTRISË SË FINANCAVE
MINISTRISË SË PUNËVE TË BRENDSHME
MINISTRISË SË DREJTËSISË
PROKURORISË SË PËRGJITHSHME
SHISH
BANKË SË SHQIPËRISË
DREJTORISË SË PËRGJITHSHME TË PARANDALIMIT
TË PASTRIMIT TË PARAVE
QENDRË SË BOTIMEVE ZYRTARE

Sekretari i Përgjithshëm

Engjëll AGAÇI

A handwritten signature in black ink, appearing to read 'Engjëll Agaçi', written over a faint circular stamp.